



## NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (i rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

**Specialist (SMR)** në Sektorin e Mirëmbajtjes së Nënstacioneve, Njësia Operative Shkodër (NJOSH)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon dhe teston mbrojtjet rele për fiderat 10 kV 20 kV dhe 35 kV .
- Kontrollon gjëndjen dhe raporton në mënyre periodike për reletë e nënstacioneve nën varesi.
- Realizon modifikime teknike të nevojshme në skemat sekondare me orientimin e SMR.
- Kryen riparime të mundshme të releve të dëmtuara së bashku me SMR.
- Analizon avaritë e përditshme në nënstacionet e njësise operative dhe raporton pranë SMR.
- Jep sugjerime për zëvendësime relesh, modifikime skemash sipas nevojave.
- Mban një grafik të detajuar të remonteve të mbrojtjeve rele si dhe për avarite për çdo mbrojtje.
- Merr detyra nga Shef Sektorit të Mbrojtjes Rele pranë DRRT /DSHMT.
- Merr pjesë në zgjidhjen e avarive që mund të ndodhin së bashku me specialistet e SMR.
- Është përgjegjës për sistemet e mbrojtjes rele në nënstacionet e njësise operative për sigurimin e mbarevajtjes tyre sistemeve DC dhe të rrymes vazhduar.

### Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;



- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara;
- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 2 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

## **ARSIMI I KËRKUAR:**

I lartë - Inxhinieri elektrike (Master shkencor ose Diplome ekuivalente).

## **Dokumentat për dorëzim**

### **Faza e Vlerësimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: [info@ost.al](mailto:info@ost.al), këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të lartë
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

**Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.**

## **Mënyra e vlerësimit:**

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.



Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

## **Dokumentat për dorëzim**

### **Faza e lidhjes së kontratës:**

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore
2. Fotokopje e noterizuar diplomës së bashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata
7. Vërtetim nga prokuroria
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi

**###**